

NJOFTIM
Nr. 247/2, datë 12.1.2026

PËR SHITJE ME ANKAND TË PRONËS SHTETËRORE ME VENDNDODHJE NË
THETH, NJËSIA ADMINISTRATIVE SHALË, BASHKIA SHKODËR

1. Objektet me vendndodhje në Theth, Njësia Administrative Shalë, Bashkia Shkodër

Nr .	Emërtimi	Vend-ndodhja	Vlera (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme m ²	Sipërfaqja nën objekt m ²	Zhvillimi i ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit	Objekt	Truall			Data	Ora	Vendi
1	Objekti nr. 1: “Ish-Bar-kafe”, “Ish-Dyqan veshmbathjeje” dhe “Ish-Dyqan ushqimor”; Objekti nr. 2: “Ish-Zyra e administrimit”; Objekti nr. 3: “Ish-Magazinë për rezervat dimërore”; dhe Objekti nr. 4: “Ish-Pika e grumbullimit të bimëve medicinale”	Theth, Njësia Administrative Shalë, Bashkia Shkodër	1,866,820	1,047,592	819,228	2796	649	10.2.2026	10:00	DSHP

Çdo person fizik apo juridik, i interesuar për blerje, duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit, dokumentacionin, si më poshtë:

1. Kërkesë me shkrim për blerje e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit.

2. Garancinë bankare, apo mandatpagesën, në origjinal, që vërteton ngurtësimin e 20% të vlerës së fillimit të ankandit, në lekë, për llogari të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit.

3. Dokument identifikimi (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).

Shënim. Pjesëmarrësit në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e shpallur për shitje, i konfiskohet 20% e garancisë bankare, e ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

Garancia bankare, apo mandatpagesa, duhet të bëhet detyrimsht brenda afatit të pranimi të kërkesave për pjesëmarrje në ankand. Garancia bankare, apo mandatpagesa, mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit, pasi të keni tërhequr pranë DSHPP-së faturën për arkëtim të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.